



V E N D I M
Nr. 105 Datë 04.09. 2008

PËR

**NJË DEVIJIM NGA RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROÇEDURAVE TË ERE-s
NË LIDHJE ME PROÇESIN E RISHIKIMIT TË RREGULLORES PËR
PROÇEDURAT E LIÇENSIMIT**

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit Nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 38, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 44, datë 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04/09/2008, pasi vendosi të fillojë procedurat për rishikimin e Rregullores për Proçedurat e Liçensimit,

Duke konstatuar,

- Nevojën për plotësimin në një kohë të shkurtër të kuadrit rregullator në sektorin e energjisë elektrike si pjesë e rëndësishme e proçesit të privatizimit të OSSH sh.a

VENDOSI :

1. Të kryejë një devijim nga neni 26 i Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s në lidhje me afatin e botimit të njoftimit dhe të marrjes së komenteve nga palët e interesuara mbi draftin e Rregullores për Proçedurat e Liçensimit.




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I
ENERGJISË
Bordi i Komisionereve



-
2. Afati i botimit të njoftimit në gazetë bëhet 2 ditë dhe afati i pritjes së komenteve për Rregulloren e Proçedurave të Liçensimit është deri më datë 08 .09.2008.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut si dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për ndjekjen e proçedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.105 date 04.09.2008

PËR

**NJË DEVIJIM NGA RREGULLAT E PRAKTIKËS DHE PROCEDURAVE TË ERE
NË LIDHJE ME PROÇESIN E RISHIKIMIT TË RREGULLORES PËR
PROÇEDURAT E LIÇENSIMIT**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____